REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 285 119
Datë/Datum. 25.06.19
PRISHTINË • PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

DATË/A:	**25.06.2019**
REFERENC-Ë:	**285 / 19**
PËR/ZA/TO:	**AK –"Kuvendi Komunal Viti"** **OE – "Arlindi"shpk - Ferizaj**
NGA/OD/FROM:	**Goran Milenković** **Kryetar i Panelit Shqyrtues-OSHP**
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	**N J O F T I M**

Operatori Ekonomik: OE - "Arlindi"shpk si palë e pa kënaqur më datën: 06.06.2019, ka parashtruar ankesë me nr. 285 / 19, pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit, kundër njoftimit për dhënie te kontratë lidhur me aktivitetit te prokurimit me titull: "Rregullimi i lumenjve dhe prrockave " me nr. të Prokurimit : 657-19-016-521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - "Kuvendi Komunal Viti" duke pretenduar se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së,

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 10.06.2019, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar procesin e aktivitetit të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve ankimore të OE – "Arlindi"shpk

Eksperti i OSHP-së më datën: 17.06.2019, ka dorëzuar raportin me të gjitha sqarimet dhe rekomandimin e tij lidhur me ankesën e lartpërmendur, me ç'rast ka vlerësuar se pretendimet e parashtruesit të ankesës OE – "Arlindi"shpk është e bazuara dhe rrjedhimisht ka rekomanduar panelin shqyrtues që te aprovoj si te bazuar ankesën e OE- ankues dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet ***RI – VLERSIM***

Me datën: 17.06.2019, Autoriteti Kontraktues: AK - "Kuvendi Komunal Viti" si dhe parashtruesi i ankesës: OE- "Arlindi"shpk e kanë pranuar raportin e ekspertizës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rregullimi i lumenjve dhe prrockave " me nr. të Prokurimit : 657-19-016-521

Autoriteti kontraktues AK- "Kuvendi Komunal Viti" përmes parashtresës së datës: 20.06.2019, pas pranimit te raportit te ekspertit shqyrtues ka njoftuar OSHP-në, se **PAJTOHET** me mendimin e dhënë të ekspertit të OSHP-së në raportin e datës: 17.06.2019

Operatori ekonomik: OE "Arlindi"shpk përmes parashtresës së datës: 18.06.2019 ka njoftuar OSHP-në , se **PAJTOHET** me mendimin e dhenë të ekspertit të OSHP-së në raportin e datës: 17.06.2019

Paneli Shqyrtues, njofton OE ankues dhe Autoritetin Kontraktues, se konform nenit 115 pika 3 të LPP-së, procedura e ankesës përfundon në këtë fazë. Autoriteti Kontraktues: AK- "Kuvendi Komunal Viti" lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rregullimi i lumenjve dhe prrockave " me nr. të Prokurimit : 657-19-016-521 të kthehet në ***RI - VLERSIM*** ky aktivitet i prokurimit, sipas rekomandimeve të ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues, kërkon nga Autoriteti Kontraktues, zbatimin e rekomandimit të ekspertit shqyrtues, dhe në afat prej 10 ditësh ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Operatorit ekonomik ankues OE – "Arlindi"shpk konform nenit 118 pika 3 të LPP-së, i kthehet sigurimi i ankesës. Urdhërohet OE ankues që konform nenit 33 pika 6 e Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Përbërja e Panelit Shqyrtues:

z. **Goran Milenković** _____ Kryetari i Panelit Shqyrtues,

z. **Nuhi Paçarizi** _____ Referues,

z. **Blerim Dina** _____ Anëtar.